



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

Nr.Prot. _____

Tiranë ___/___/2016

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë **02/09/2016**

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tirane

Për: Operatorin ekonomik, **AL-TEK sh.p.k** me NIPT **K48130519Q**.

Adresa: Vaqarr, Rruga nacionale, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozime

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë “Kërkesë për Propozime” me objekt “**Blerje pellet dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore**”, kohëzgjatja e kontratës deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: **2.450.000 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.08.2016

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **AL-TEK sh.p.k** me NIPT **K48130519Q**, me seli ne Adresa: Vaqarr, Rruga nacionale, Tiranë, me ofertë **2,431,000 (dy milion e katërqind tridhjetë e një mijë)** Lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**BOLT**” sh.p.k me NIPT **K91517011V** me seli ne Adresa: Rr.Dritan Hoxha, Blloku Qintash, Laprakë, Tiranë me ofertë **2,386,120 (dy milion e treqind tetëdhjetëe gjashtë mijë e njëqind e njëzet)** Lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “**ALCANI**” Sh.p.k me NIPT **J91505006Q**, me adrese Rruga “Frutikulturës”, Kamëz, Tirane, me ofertë **2,449,700** (dy milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH.

Skualifikohet:

1. Operatori ekonomik “**BOLT**” sh.p.k me NIPT **K91517011V** për shkak se nuk plotëson kriteret e veçanta sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat janë si më poshtë;
- a) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të mallit objekt prokurimi, kriter i vendosur nga Autoriteti Kontraktor.
 - b) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur raportet e testimi të mallit objekt prokurimi të kërkuara në DST-ë nga Autoriteti Kontraktor.
 - c) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën ku merr përsipër shpërndarjen e pelletit me punonjësit dhe me automjetet e tij në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
 - d) Parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për automjetet. Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar disponimi në pronësi ose me qira i të paktën dy mjeteve të transportit me kapacitet mbi 1 ton të cilat do të përdoren për shpërndarjen e pelletit në objekte, për të cilat kërkohet leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit. Operatori Ekonomik “Bolt” sh.p.k ka mangësira në këtë kriter të vendosur nga Autoriteti Kontraktor. Për mjetin me targë AA 874 KA operatori ekonomik ka paraqitur vetëm çertifikatën e kontrollit teknik. Ndërsa për mjetin e dytë me targë AA 627HD operatori ekonomik ka paraqitur çertifikatën e pronësisë të vlefshme, siguracionin e mjetit i cili ka skaduar me datë 04.08.2016 kur afati për dorëzimin e ofertave ka qënë me datë 15.08.2016. Duhet të paraqitej siguracioni i vitit pasardhës. Operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu çertifikatën e kontrollit teknik e cila është e vlefshme deri më datë 05.08.2016 kur afati për dorëzimin e ofertave ka qënë me datë 15.08.2016 dhe duhet të paraqitej çertifikata e kontrollit teknik e vitit pasardhës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatorin ekonomik; **AL-TEK sh.p.k me NIPT K48130519Q**, me seli ne Adresa: Vaqarr Rruga nacionale, Tiranë, se oferta me vlerë **2,431,000** (dy milion e katërqind tridhjetë e një mijë) **Lekë pa TVSH**, e paraqitur për

tenderin me objekt **“Blerje pellet dhe shperndarje ne objektet shkollore dhe parashkollore”**, me afat të kryerjes së shërbimeve deri 31.12.2016 nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe fitues do të shpallet operatori ekonomik i renditur i dyti **“ALCANI” Sh.p.k, NIPT J91505006Q** me ofertë 2,449,700 (dy milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë pa TVSH, sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 **“Për prokurimet publike”**.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25/08/2016

Ankesa: S`ka pasur

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Artion ÇAUSHLLARI